



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1421/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përbarimore të kreditorit DPH A....në Prizren, rruga 1 Tetori, kundër debitorit Ministria e Diasporës në Prishtinë, rruga Zenel Salihu p.n., me bazë juridike, përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1214/20 të datës 08.04.2021, jashtë seancës me datën 16.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit DPH A....në Prizren, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1214/20 i datës 08.04.2021, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1214/20 të datës 08.04.2021, e ka Aprovuar prapësimin e debitorit Ministria e Diasporës në Prishtinë, rruga Zenel Salihu p.n., dhe ka Anuluar urdhërin përbarimor P.nr.323/2018 dt.17.04.2018 i lëshuar nga zyra përbarimore e përbaruesit privat Rushit Hoxha në territorin e Gjykatës Themelore në Prizren.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, të anulohet aktvendimi PPP.nr.1214/20, dhe lënda ti kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë, ose i njëjti aktvendim të ndryshohet dhe të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri i përbaruesit privat P.nr.328/2018 dt.17.05.2018. Arsyetimi i vendimit ankimor është në kundërshtim me vet dispozitën ligjore sepse askund nuk ceket se fatura duhet të jetë e dorëzuar në zyre të protokolimit. Faturën e ka pranuar zyrtarja e debitorit L.H., e cila edhe e ka rezervuar shërbimin dhe ka marrë porosinë nga kreditori, kështu që në këtë formë e njëjta ministri ka shlyer disa

fatura nja e njëjta zyrtare, nuk është faji i kreditorit se përse fatura nuk është shlyer ose proceduar nga ana e vet zyrtarëve të Ministrisë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbirim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës nr.188 e dt.12.10.2017. Përmbiruesi privat Rushit Hoxha nga Prizreni, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbirimor P.nr.323/2018 të datës 17.04.2018, ka lejuar përmbirimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën prej 624.50€.

Kundër urdhrin përmbirimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 02.05.2018, me pretendimin se fatura nuk është pranuar nga pala debitore, pasi as nuk janë dorëzuar zyrtarisht, nuk ka vulë zyrtare të debitorit e as numër protokollit.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 16.05.2018, duke arsyetuar se dokumenti përmbirues i plotëson të gjitha kushtet dhe zakonisht personi përgjegjës i nënshkruar faturat në kuadër të departamentit përkatës për shlyerjen e obligimeve.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave tjera ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.1214/20 të datës 08.04.2021, me të cilin e ka aprovuar prapësimin e debitorit Ministria e Diasporës në Prishtinë, rruga Zenel Salihu p.n., dhe ka anuluar urdhrin përmbirimor P.nr.323/2018 dt.17.04.2018 i lëshuar nga zyra përmbimore e përmbiruesit privat Rushit Hoxha në territorin e Gjykatës Themelore në Prizren. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se në riprocedurë gjykata ka vlerësuar dokumentin e besueshëm faturën nr.188 dt.12.10.2017 në bazë të së cilës përmbiruesi privat ka zbatuar përmbirimin, mirëpo këtë faturë debitori nuk e ka pranuar, nuk ka provë dëshmi se kjo faturë është dorëzuar në mënyrë zyrtare tek zyra kompetente e organit që kërkohet të realizohet borxhi, andaj në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e parapara me nenin 29 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale–Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbimore kur ka aprovuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbiruesit privat, me të cilin është caktuar përmbirimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës, qartë konstatohet se përmbirimi është lejuar në bazë të faturës nr.188/12.10.2017 e lëshuar nga kreditori, e cila faturë në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika

1.3 të LPP-së, nuk e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe se i njëjti dokument nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit Ligj.

Në rastin konkret Dhoma e Shkallës së Dytë, pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK-së, dhe se e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së. Vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës, të cilën kreditori ia ka bashkangjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, ngase fatura nr.188/12.10.2017 e lëshuar nga kreditori, në bazë të së cilës është caktuar përmbarimi, nuk është e pranuar dhe protokoluar nga debitori. Sa i përket pretendimeve të debitorit në lidhje me borxhin real të pretenduar, se faturën e ka pranuar zyrtarja e debitorit, kjo gjykatë të njëjtat i vlerësoi vetëm deklarative dhe pa mbështetje në prova konkrete siç parasheh neni 69 par.4 të LPP-së.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura, e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1421/22 me datë 16.11.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha